



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 4.3.2025

Nr: 16

Ora: 16:30

VENDIM

PËR

DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 10, DATË 23.10.2024 "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËRGATITJEN E LISTËS SË ZGJEDHËSVE, TE NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 12, pika 4, nenit 20, pika 1, shkronja "dh", nenit 24 pika 5, nenit 25, pikat 1 dhe 12, nenit 46, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e dy anëtarëve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

- Në pikën 6, të Kreut II "Rregulla të përgjithshme", togfjalëshi "...përfundon 68 ditë para kësaj date.", riformulohet si vijon: "...përfundon 63 ditë para kësaj date."
- Në pikën 4, të Kreut III.2 "Regjistrimi në listën e zgjedhësve", togfjalëshi "...brenda 5 ditëve...", riformulohet si vijon: "...brenda 2 ditëve..."
- Në pikën 1, të Kreut IV "Shqyrtimi i kërkesave dhe regjistrimi i zgjedhësve nga jashtë vendit", togfjalëshi "...jo më vonë se 5 ditë...", riformulohet si vijon "...jo më vonë se 2 ditë..."
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Ngarkohen Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, administrata e KQZ-së dhe institucionet e ngarkuara me detyra nga ky vendim për zbatimin e tij.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar (Kundër)

Arens ÇELA

Anëtar (Kundër)

Dritan ÇAKA

Anëtar (Kundër)

Helga VUKAJ

Anëtar (Pro)

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar (Pro)



Shënim:

Në zbatim të pikës 3, të nenit 20, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, akti nuk mori numrin e kërkuar të votave për t’u konsideruar i miratuar. Akti u votua me dy vota pro dhe tre vota kundër në parim.

